

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 17 MARS 2022

Zonja drejtuese e seancës,

Të dashura qytetare dhe qytetarë shqiptarë, që ndiqni këtë seancë kushtuar një prej problemeve më themelore të interesit kombëtar: integritit të vendit në Bashkimin Europian.

Të nderuar deputetë, e vërteta është se procesi i integritit të Shqipërisë nga viti 2014 dhe deri sot u shndërrua në një horizont, i cili i largoi gjithnjë e më shumë shqiptarët nga Shqipëria. Kjo ndodhi në mënyrë absolute për shkak të qëndrimeve ndaj standardeve të Bashkimit Europian, për shkak të politikave të jashtme që ndiqte Shqipëria, të cilat binin ndesh me ato të Bashkimit Europian, duke u endur në mjegullnajat lindore, duke e shndërruar Beogradin në kryeqytet rajonal. Në vend që të luftohej për Brukselin, luftohej për Beogradin, duke adaptuar projekte politike, dhe jo vetëm, si “Ballkani i hapur”, projekt, i cili i kundërvihej qartë nismës së Berlinit, duke dhunuar standardet dhe parimet më themelore të një demokracie, para së gjithash zgjedhjet e lira.

Në këto vite Shqipëria u largua me shpejtësi të madhe nga kriteret e Kopenhagenit, zëvendësoi shtetin ligjor me narkoshtetin; në këto vite Shqipëria zhduki transparencën dhe sot, pas 8 vjetësh, ka një borxh, sa mali i Dajtit, i cili në çdo dimension ka korrupsionin. Rezultatet e progresit në 8 vjet kanë qenë të kundërta me ato që kanë pritur shqiptarët; varfëria ekstreme është rritur 3-4 herë; varfëria e zakonshme është rritur disa herë, pavarësisht se borxhi i tyre është rritur në 103%. Në qoftë se u rrit me 4,4% në vitet 2005-2013, në 8-vjeçarin e mëpashtëm u rrit me 47%. Ku shkuan këto para? Çfarë u bë me këto para? Në tërësinë e tyre: abuzim i tmerrshëm i administratës; tenderë me çmim të 8-fishtë, krahasuar me standardin europian; orendi zyresh, rindërtime ndërtesash, shpenzime kolosale për udhëtime dhe, si përfundim, shqiptarët, nga qytetarë me rrogën mesatare më të lartë në rajon, përfunduan në qytetarët me rrogën më të ulët. Askush të mos mendojë se rroga është një kriter i pashpallur në procesin e integritit.

Në rast se rikthehemi te politika e jashtme, një politikë klienteliste, e tëra në funksion të autokracisë, por më e dëmshme, është politika rajonale, një miqësi patologjike me sundimtarin e Beogradit, i cili për qëndrimet që mban ndaj gjenocidit nuk do të mund t’ia çelë absolutisht rrugën e progresit të vendit të tij drejt BE-së. Ka një ndërgjegje Europa, dhe kjo ndërgjegje nuk e pranon dot mohimin e gjenocidit. Kjo ndërgjegje kërkon dënimin pa kushte të gjenocidit. Por ka një njeri, një vasal, që i bën tualet ditë e natë Aleksandër Vuçiçit, dhe ky është Edi Rama. Edhe kur ai deklaroi se për vendet e rajonit do të respektojë kontratat, ky i mashtron shqiptarët e thotë: “Miku im Vuçiçi për Shqipërinë do të respektojë kontratat.”. Kjo miqësi patologjike për interesa absolutisht antishqiptare e konsolidoi nismën e “Ballkanit të hapur”, të cilën Europa e denoncoi publikisht. Pra, një ecuri e tillë nuk është vendnumëro, por prapakthehu. Shqipëria nuk i plotëson në mënyrë absolute standardet.

Merrni reformën për drejtësi! A nuk e latë vendin 4 vjet pa Gjykatë të Lartë dhe pa Gjykatë Kushtetuese? Për atë që ka ABC-në e shtetit, e di se kjo do të thotë të asgjësosh shtetin ligjor, se shteti ligjor nuk ekziston pa institucionet e larta të drejtësisë. E bëtë për t'i kontrolluar. Ja ku i keni tani! Shikoni funksionimin e tyre! Janë garanci për të mos ecur drejt BE-së. Por, përveç këtyre, kjo maxhorancë dëshmon një arrogancë çnjerëzore, të paimagjinueshme ndaj qytetarëve të saj këto ditë. Një njeri, i cili është përgjegjës për gjithë këtë dramë, u deklaroi me krenari shqiptarëve se nuk do të lëvizë asnjë taksë. Unë ju ftoj ju, zotërinj deputetë, të hapni pak të dhënat e Byrgenit dhe do të gjeni atje se çdo vend i BE-së i ka lëvizur taksat, ka hequr ose e ka reduktuar në shkallë maksimale TVSH-në, ka subvencionuar naftën, që ne e tatojmë me 4 taksa dhe 3 tarifa me 1218 lekë, sepse nuk i merr dot taksat në fusha të tjera, por ka gjetur naftën, ka gjetur miellin, vajin për t'i dënuar shqiptarët. A e dini ju se është trefishuar vaji i gatimit? Po, po, nuk ka diskutim, se nuk ju interesojnë këto. Juve ju interesojnë fasadat, ju intereson të lustroni. Ku është ajo zonja, që bën gara me Spiropalin për të hyjnizuar Edi Ramën, kjo Edona Bilali, e cila u thotë shqiptarëve se ky po bëhet Zeus?! Po ç'e keni këtë mani?